



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

Prishtinë, 4 Shkurt 2009

Për: Zt. Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave
Zt. Mahir Jagcillar, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
Sadri Ferati, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje: Zt. Dëfrim Byqmeti, U.D i Drejtorit Menaxhues të KLMC SH. A.

Lënda: **Problemet Serioze në Menaxhimin e Deponive Sanitare në Kosovë dhe Propozimi i Masave për Tejkalimin e Situatës**

Të nderuar zt. Ministra,

Deponitë sanitare në Kosovë, të cilat menaxhohen nga KLMC SH.A. e që janë të ndërtuara me fondet e investuara nga donatorët, aktualisht janë në një gjendje jashtëzakonisht të keqe si pasojë e mosmenaxhimit të duhur të tyre. Kjo gjendje jo vetëm që paraqet kërcënim serioz për mjedisin dhe për shëndetin e popullatës që jeton në afërsi të këtyre deponive, por edhe ka për pasojë dëmtime të rënda në objektet e deponive, riparimi i të cilave do të këtë kosto të lartë.

Arësytet e mosmenaxhimit të mirë të deponive sanitare janë të shumëta, por arësyeja kryesore është pamundësia e KLMC SH.A. që të arkëtojë borxhet e veta nga kompanitë regionale të grumbullimit të mbeturinave të cilat deponojnë mbeturinat në këto deponi. Kjo ka sjellë deri te situata kur KLMC SH.A. nuk ka mundësi të operojë sipas standardeve të parapara deponitë dhe nuk ka mundësi të ndërmerr investimet e nevojshme për riparimin dhe rehabilitimin e deponive.

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM), si rregullator ekonomik i veprimtarisë së këtyre kompanive, në kuadër të kompetencave të veta ligjore ka tentuar që në forma të ndryshme ta adresojë këtë problem në bashkëpunim me palët tjera të interesit, por fatkeqësisht deri tani nuk ka pasur sukses. Prandaj, me qëllim të tejkalimit të problemeve të krijuara, bashkangjitur me këtë letër, po ju dërgoj një propozim të masave dhe veprimeve që konsideroj se do të duhej të ndërmirren për zgjidhjen të këtij problemi.

Shpresoj se çështjen e ngritur do ta trajtoni me vëmendjen e duhur dhe se me autoritetin e juaj do të angazhoheni që të ndërmirren veprime të shpejta dhe efektive për tejkalimin e këtij problemi serioz.

Me respekt,

Afrim Lajçi
Drejtor i ZRRUM

Propozim i Masave dhe Veprimeve për Tejkalimin e Problemeve në Menaxhimin e Deponive në Kosovë

Menaxhimi i mirë i mbeturinave në formën që nuk e rrezikon mjedisin dhe shëndetin e popullatës është me rëndësi fundamentale për secilin vend. Për Kosovën e cila aspiron integrimin në BE është me rëndësi të veçantë që të këtë një progres në fushën e menaxhimit të mbeturinave në pajtim me rekomandimet dhe direktivat e BE-së.

1. Gjendja aktuale e përgjithshme në menaxhimin e mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave, në parim përfshinë dy aspekte kryesore: (i) grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, dhe (ii) deponimin final të mbeturinave.

Është evidente se në Kosovë aktualisht në të dy këto segmente të menaxhimit të mbeturinave gjendja nuk është e mirë. Kjo gjendje pasqyrohet në ambientin e papastër që është i dukshëm në të gjitha vendbanimet e Kosovës.

Disa prej arsyeve kryesore për gjendjen e keqe në menaxhimin e mbeturinave janë:

- (a) Mungesa e Planit Strategjik Nacional për Menaxhimin e Mbeturinave;
 - (b) Mungesa e qartësisë për rolin dhe përgjegjësitë institucionale në menaxhimin e mbeturinave;
 - (c) Mungesa e ekspertizës dhe kapaciteteve profesionale të nevojshme në lëminë e menaxhimit të mbeturinave;
- (a) **Mungesa e Planit Strategjik Nacional për Menaxhimin e Mbeturinave** është një problem fundamental për Kosovën. Ky Plan që do të duhej të përpilohej nga MMPH (në bashkëpunim me palët tjera të interesit) është prioriteti kryesor për sektorin e mbeturinave në Kosovë. Me këtë Plan do të deinohej strategjia afatgjate e Kosovës në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe do të përcaktoheshin politikat qeveritare për çështjet vitale në këtë sektor si: roli dhe përgjegjësitë institucionale, roli i sektorit privat në menaxhimin e mbeturinave, çështjet teknike dhe rregullative, çështjet financiare etj.
- (b) **Mungesa e qartësisë së përgjegjësive institucionale** në lidhje me menaxhimin e mbeturinave, është si rezultat i mungesës së politikave të qarta për sektorin e menaxhimit të mbeturinave si dhe mos-harmonizimit të legjislacionit që e rregullon këtë fushë (në veçanti ndërmjet Ligjit për Mbeturinat dhe Ligji për Rregullimin e Aktiviteteve të Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave-Nr. 03/L-086). Kjo në praktikë iu mundëson palëve që të interpretojnë ligjet sipas dëshirës dhe të gjejnë justifikim për mosveprim në adresimin e problemeve.
- (c) **Mungesa e ekspertizës së nevojshme profesionale** në fushën e menaxhimit të mbeturinave është prezente në të gjitha institucionet që kanë përgjegjësi të caktuara në këtë sektor (ministri, komuna, kompani publike etj.). Si pasojë e kësaj mungese, dhe pjesërisht në mungesë të vullnetit politik kemi ngecjet në hartimin e planeve nacionale dhe komunale të menaxhimit të mbeturinave që në instancë të fundit reflektohet me një menaxhim jocilësor të mbeturinave në Kosovë.

2. Menaxhimi i deponive në Kosovë

2.1. Deponitë sanitare dhe autoritet përgjegjëse për menaxhimin e tyre

Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave si një segment i sistemit të menaxhimit të mbeturinave *kryhet nga 7 kompani regjionale* të cilat janë korporata (shoqëri aksionare) në pronësi të komunave përkatëse dhe janë të licencuara nga ZRRUM.

Ndërkaq **menaxhimi i deponive** në Kosovë kryhet nga:

- (a) Kompania për Menaxhimin e Deponive – KLMC SH.A. e cila ka statusin e ndërmarrjes publike qendrore dhe është në pronësi të Republikës së Kosovës. KLMC është e licencuar nga ZRRUM për menaxhimin e deponive sanitare si vijon:
 - i. Deponinë e Prishtinës
 - ii. Deponinë e Gjilanit
 - iii. Deponinë e Prizrenit
 - iv. Deponinë e Podujevës
 - v. Stacionin e Transferit në Ferizaj
- (b) Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ambienti SH.A.”, Pejë e cila menaxhon deponinë regjionale në Pejë dhe është licencuar nga ZRRUM;
- (c) Kompania Regjionale Mbeturinave “Uniteti SH.A.”, Mitrovicë e cila menaxhon deponinë regjionale në Mitrovicë dhe është e licencuar nga ZRRUM;
- (d) Kompania Komunale e Mbeturinave në Zveçan e cila menaxhon deponinë sanitare në Zveçan dhe nuk është e licencuar nga ZRRUM;

Deponitë e vjetra komunale jo-sanitare të cilat janë shfrytëzuar më herët janë mbyllur ose janë në proces të mbylljes.

Në fakt, koncepti për menaxhimin e deponive në Kosovë ka qenë që të gjitha deponitë sanitare (duke përfshi edhe ato të Pejës, Mitrovicës dhe Zveçanit) të bëhet nga një kompani qendrore (KLMC) e cila do të menaxhonte ato përmes operatorëve privat. Ky koncept i cili ka qenë adoptuar në vitin 2002 nga AKM, IPVQ-të dhe donatorët, nuk është funksionalizuar deri në fund për shkak të mos-rregullimit të çështjeve pronësore me komunat e Pejës, Mitrovicës dhe Zveçanit.

Aktualisht, problemet më të mëdha në fushën e menaxhimit të deponive manifestohen te rasti i deponive të cilat i menaxhon KLMC. Kjo kompani funksionon si shoqëri aksionare sipas parimeve vijuese:

- KLMC ka raporte kontraktuale me kompanitë regjionale të mbeturinave të cilat i deponojnë mbeturinat e tyre në deponitë që i menaxhon KLMC. Kompanitë regjionale të mbeturinave duhet të paguajnë për mbeturinat e deponuara sipas tarifave të cilat i përcakton ZRRUM;
- KLMC përmes procedurës së tenderit të hapur i angazhon operatorët privat për operimin e deponive të cilat i menaxhon ajo;
- KLMC është përgjegjëse për operimin e deponive në pajtim me standardet mjedisore në fuqi (të cilat i përcakton MMPH).

2.2. Shkaqet e problemit

Fillimisht, pas themelimit të KLMC-së në 2005, përderisa KLMC ka qenë nën autoritetin menaxhues të AKM-së, AKM ka siguruar fondet për operimin e KLMC-së prej mjeteve të buxhetit qendror të cilat iu janë alokuar kompanive regjionale të mbeturinave me destinim për pagesën e KLMC-së për mbeturinat e deponuara. Në këtë periudhë deponitë janë operuar me standarde të larta dhe kanë model i mirë për vendet tjera të regjionit.

Prej vitit 2007 ka filluar reduktimi i mjeteve të BKK për kompanitë regjionale të mbeturinave me kusht që ato të paguajnë KLMC-në prej të hyrave të veta. Këtu kanë filluar problemet financiare për KLMC-në duke qenë se kompanitë regjionale (në veçanti "Pastrimi SH. A", Prishtinë dhe "Ekoregjioni SH.A. Prizren) nuk kanë kryer obligimet e tyre ndaj KLMC-së me pretekstin se nuk kanë mjete për të kryer pagesën ndaj KLMC-së. Kjo për pasojë ka shkaktuar pamundësinë e KLMC-së për ti paguar operatorët privat dhe për të ndërmarrë investimet e nevojshme në deponitë sanitare.

Pra problem kyç në operimin e deponive paraqet pamundësia e KLMC-së për të financuar aktivitetin e vet si rezultat i mos-arkëtimit të borxheve të cilat i kanë kompanitë regjionale të mbeturinave.

3. Përpjekjet e deritashme për tejkalimin e problemeve

ZRRUM, si autoritet përgjegjës për rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të mbeturinave, me inspektimet në vend të ngjarjes ka konstatuar gjendjen e keqe në deponitë që menaxhohen nga KLMC si rezultat i mosmenaxhimit adekuat të këtyre deponive.

Në kuadër të përpjekjeve për rivendosjen e operimit të mirë në deponi, ZRRUM ka ftuar më 12 Gusht 2008 një takim me të gjitha palët e interesit (MEF, MMPH, KLMC, komunitat) për të diskutuar rrugëdaljen nga situata e krijuar.

Pas këtij takimi ZRRUM ka dërguar një Paralajmërim për marrjen e licencës së shërbimit të KLMC-së për shkak të menaxhimit të dobët të deponive (më 12 Gusht 2008). Mëpastaj ZRRUM bashkë me menaxhmentin e KLMC-së gjatë muajit shtator dhe tetor ka pasur takime me Ministrin e MEF-it dhe me Ministrin e MMPH-së me qëllim të shqyrtimit të opsioneve për gjetjen e një zgjidhje për situatën e krijuar.

Dhe përfundimisht më 31 tetor 2008 është mbajtur një takim në MMPH me përfaqësuesit e të gjitha institucioneve relevante për gjetjen e zgjidhjes për problemin e deponive.

Nga të gjitha këto takime nuk ka pasur ndonjë efekt që do të ndikonte në përmirësimin e situatës dhe për pasojë gjendja e deponive të cilat menaxhohen nga KLMC aktualisht është alarmante me kërcënim serioz për shëndetin publik dhe për mjedisin.

Përfundimisht, më 3 shkurt 2009, ZRRUM i ka dërguar edhe një Paralajmërim KLMC-së për marrjen e licencës së shërbimit nëse në afat prej 15 ditësh nuk rivendoset operimi i mirë i deponive. Kjo është masa e vetme e mbetur që mund ta ndërmerr ZRRUM në

pajtim me autoritetin e vet të përcaktuar me ligj, dhe ZRRUM është i shtrënguar ta marrë një vendim të tillë.

4. Propozimi i masave dhe veprimeve të menjëhershme

Institucionet përgjegjëse deri tashmi kanë dështuar ta zgjidhin problemin e krijuar të menaxhimit të deponive. Përkundër takimeve të shumta dhe konstatimeve të shumta nga të gjitha nivelet e inspekcioneve (të MMPH-së, ZRRUM-it, ata komunalë etj.) problemi ka mbetur i pazgjidhur. Për më tepër gjendja në deponi është degraduar vazhdimisht.

Për tejkalimin e problemit duhet që para së gjithash të kuptohet pesha e vërtetë, shumë serioze, e problemit. Rrjedhimisht, duhet që të ndërmerret një veprim urgjent dhe i harmonizuar me pjesëmarrjen aktive të nivelit më të lartë të institucioneve relevante: (i) Qeverisë si pronare e KLMC-së, (ii) MMPH-së si autoritet përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë, (iii) komunave si pronare të kompanive regjionale, dhe (iv) ZRRUM-it si autoritet rregullator i ofruesve të shërbimeve të mbeturinave.

Konkretisht, propozoj që duhet të ndërmerren veprimet vijuese nga institucionet relevante në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë respektive që kanë ato në bazë të ligjit:

- (a) **Qeveria e Kosovës**, përmes këshillit të ministrave, në pajtim me nenin 5 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike si autoritet që ushtron të drejtën e pronësisë mbi KLMC-në duhet të shqyrtojë problemet financiare të KLMC-së dhe të gjej një **zgjidhje urgjente** e cila do të sigurojë operimin e KLMC-së dhe do të implemtohet prej Ministrisë të MEF-it. Zgjidhja do të mund të ishte dhënia e huasë apo grantit për KLMC-në për të tejkaluar vështirësitë financiare dhe për të qenë në gjendje të operojë deponitë sipas standardeve të kërkuara. Poashtu qeveria duhet të ofrojë mbështetje për KLMC-në në arkëtimin e borxheve të cilat kompanitë regjionale të mbeturinave i kanë ndaj saj.
- (b) **KLMC**, përmes rrugës ligjore, të arkëtojë borxhet nga kompanitë regjionale të mbeturinave dhe të normalizojë operimin e deponive. Me arkëtimin e borxheve KLMC do të kthente huatë e marra nga Qeveria. Poashtu, KLMC duhet të rishikojë modalitetet e operimit të deponive dhe të gjejë zgjidhje më optimale për operimin e tyre. Ky rishikim i modelit ekzistues të operimit do të nënkuptonte shqyrtimin e opsioneve vijuese: (i) të modifikohen kontratat me operatorët privat (në kuptim të mirëmbajtjes së mekanizimit) ose (ii) operimi i deponive të bëhet nga vetë KLMC (pa kontraktimin e operatorëve privat), ose (iii) ndonjë opsion tjetër (p.sh. marrëveshja me kompanitë regjionale të mbeturinave që ato të operojnë deponitë përkohësisht).
- (c) **MMPH**, të ngrisë në qeverinë e Kosovës problemin aktual të gjendjes alarmante në deponitë sanitare me tërë peshën dhe implikimet mjedisore dhe financiare që ka ky problem dhe të angazhohet aktivisht për zgjidhjen e tij. MMPH poashtu do të duhej të përcaktojë saktësisht të gjitha standardet teknike dhe mjedisore që duhet të përmbushë KLMC për operimin e deponive sanitare dhe të mbikqyrë plotësimin e këtyre standardeve nga ana e KLMC-së.

- (d) **Komunat**, si pronare të kompanive regjionale të mbeturinave duhet ta ekzekutojnë funksionin e pronarit në mënyrë efektive dhe të mbështesin qëndrueshmërinë financiare të këtyre kompanive. Kjo mbështetje do të nënkuptonte (subvencionimin e faturave për rastet sociale, përkrahjen institucionale për arkëtimin e faturave nga konsumatorët etj.).
- (e) **ZRRUM**, si rregullator ekonomik i ofruesve të shërbimeve të mbeturinave, duhet të mbikqyrë performancën e këtyre kompanive (duke përfshi edhe KLMC-në), dhe poashtu të sigurojë që tarifat e shërbimit janë të mjaftueshme për gjenerimin e të hyrave që mundësojnë funksionimin normal të këtyre kompanive sipas standardeve të përcaktuara të shërbimit. Në situatën aktuale ZRRUM duhet që pas konsultimit me institucionet relevante (MEF, MMPH, komunat) të revokojë licencën e shërbimit për KLMC-në dhe të kërkojë nga Qeveria e Kosovës që të gjej zgjidhje për menaxhimin e deponive.

5. Propozim i masave afatshkurta dhe afatmesme

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë duke i marrë parasysh problemet aktuale duhet të rishikohet me qëllim të krijimit të një strukture institucionale dhe një ambienti të përshtatshëm që do të mundësonte menaxhim efektiv të mbeturinave në Kosovë.

Nën rolin udhëheqës të MMPH do të duhej të ndërmerren veprime të harmonizuara të cilat do të përfshinin:

- (a) Inicimin e hartimit të Planit Strategjik Nacional për Menaxhimin e Mbeturinave;
- (b) Inicimin e hartimit të planeve komunale për menaxhimin e mbeturinave nga të gjitha komunat e Kosovës në pajtim me Planin Nacional;
- (c) Inicimin e harmonizimit të legjislacionit dhe eliminimin e kundërthënive që aktualisht ekzistojnë lidhur me rolin dhe përgjegjësitë institucionale në veçanti sa i përket përgjegjësiave për rregullimin e shërbimeve të mbeturinave;
- (d) Inicimin e ndryshimit të modelit aktual të arkëtimin të faturave për shërbimet e mbeturinave nga konsumatorët shtëpiak. Kjo do të nënkuptonte që përgjegjësia për arkëtimin e borxheve do të kalonte prej kompanive regjionale të mbeturinave tek komunat. Kjo për faktin se komunat kanë më shumë mekanizma zbatues për arkëtimin e faturave se sa kompanitë e mbeturinave;
- (e) Përforcimin e sistemit të inspektionit në nivelin qendror (inspektorët e MMPH-së) dhe në nivelin lokal (inspektorët komunal) me qëllim të kontrollimit të hudhjes së mbeturinave dhe krijimit të një mjedisi më të pastërt;
- (f) Inicimin e separimit dhe riciklimit të mbeturinave në pajtim me direktivat Europiane.